



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË GJAKOVËS PËR VITIN 2023

Raporti i nënshkruar nga
Vlora Spanca,
Auditore e Përgjithshme

Prishtinë, qershor 2024

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Gjakovës për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2023, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Gjakovës (KGj), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjes/ve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Gjakovës, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për Opinion të Kualifikuar

- B1 Komuna kishte bërë keq klasifikim të shpenzimeve në vlerë 929,959€ nga kategori ekonomike jo adekuate. Nga investimet kapitale ishin ekzekutuar pagesa në shumë 790,206€ nga thesari për vendime gjyqësore/përmbartimore për të paguara për pagat jubilarë dhe shujta, si dhe shuma prej 77,187€ janë paguar nga mallra dhe shërbime për paga dhe shujta. Po ashtu, pagesa në shumë 54,567€ nga investimet kapitale i takojnë kategorisë së mallrave dhe shërbimeve.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Komunës së Gjakovës kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

- A1 Aplikim jo i saktë i tarifës ndërtimore.
 - A2 Mangësi në pagesa për projektin kapital.
 - A3 Vonesa në përfundimin e punëve të kontraktuara.
 - B2 Dobësi në procesin e veprimtarive inspektuese të pronave.
 - B3 Dobësi në përgatitjen e specifikacionit teknik në dosjet e tenderëve.
 - B4 Vonesa në pagesën e faturave.
 - B5 Mangësi në procedimin e pagesave
 - B6 Dobësi në menaxhimin e projekteve përmes platformës elektronike të e-prokurimit
- Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë*

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetari i Komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Gjakovës.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Gjakovës është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Gjakovës në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Gjakovës me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontroleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Gjakovës.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.

- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuara me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet⁴

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha ku nevojitet përmirësim për menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm. Procesi i raportimit në Komunë ishte përcjell me mangësi, kjo ishte vërejtur edhe me rastin e përgatitjes së Pasqyrave Vjetore Financiare (PVF). Pas kërkesës sonë disa çështje të ngritura në PVF-të janë korrigjuar dhe dorëzuar në MF. Megjithatë gjatë procesit të auditimit kemi evidentuar mangësi në menaxhimin e të hyrave, llogarive të arkëtushme, klasifikimin e shpenzimeve, menaxhimin e projekteve kapitale, si dhe në procedurat e prokurimit publik të cilat janë paraqitur me poshtë në forme të gjetjeve dhe rekomandimeve. Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Ky raport ka rezultuar me 10 rekomandime, prej tyre 3 (tre) janë rekomandime të reja dhe 7 (shtatë) të përsëritura.

Nga mostrat e testuara kemi vërejtur se si rezultat i kontratës kolektive me procedurë përmbarimore gjyqësore komuna ka paguar borxhin kryesor në shumë 796,881€ për paga dhe meditje, ndërsa shpenzimet shtesë të interesit dhe procedurale të gjykatës/përmbarimit ishin 237,662€.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja B1 - Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve

Gjetja

Rregulla financiare nr. 01/2013/MF “Mbi shpenzimin e parasë publike”, neni 18 pika 3 specifikon se shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate, të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ për planin kontabël. Rrjedhimisht, neni 11 i UA 19/2009 për planin kontabël, kërkon nga ZKA dhe ZKF që të sigurojnë që të gjitha transaksionet janë regjistruar në SIMFK sipas strukturës së planit kontabël dhe klasifikimeve të përcaktuara me këtë UA.

Nga auditimi i pagesave, si dhe shpalosjet në raportin vjetor financiar, si rezultat i vendimeve gjyqësore, nga Thesari janë realizuar pagesa në vlerë 921,959€.

- Nga kategoria e investimeve kapitale janë paguar 790,206€ për shpenzimet që i takojnë kategorisë së pagave dhe mëditjeve/shujtave, si dhe për mallra dhe shërbime në shumë prej 54,567€; dhe
- Nga kategoria mallrave dhe shërbimeve janë paguar 77,187€ për shpenzimet që i takojnë kategorisë së pagave dhe mëditjeve/shujtave.

Duhet cekur se Komuna e Gjakovës kishte bërë kërkesë në Ministrinë e Financave Punës dhe Transfereve (MFPT) që ti mundësohet tranferi i mjeteve nga kategoria e investimeve kapitale në kategorinë e pagave, dhe nga ministria është kërkuar që kjo kërkesë të aprovohet në kuvendin komunal. Edhe për kundër faktit se komuna e kishte marrë aprovimin nga kuvendi komunal, ministria në shkresën pasuese nuk kishte lejuar transferin e mjeteve sipas kërkesës së komunës.

Pagesat për paga jubilarë dhe shujta kanë ndodhur si rezultat i kontratës kolektive shpenzimet e të cilave nuk janë planifikuar në buxhet dhe keq klasifikimi ka ndodhur si rezultat i regjistrimit të shpenzimeve jo sipas kategorive ekonomike përkatëse.

Ndikimi

Keq klasifikimi i shpenzimeve rezulton me pasqyrimin jo të drejtë dhe të saktë të shpenzimeve në PVF, rrjedhimisht mund të shpie në keqkuptim të pozitës financiare të komunës me mbivlerësim/ nënvlerësim të kategorive ekonomike.

Rekomandimi B1

Kryetari duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit (apo të ridestinoohen mjetet kur është e nevojshme dhe e mundshme), që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve të bëhet sipas kodeve ekonomike adekuate.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja A1 - Aplikim jo i saktë i tarifës ndërtimore

Gjetja Rregullorja 2022 për taksa komunale për leje ndërtimi dhe leje rrënimi, neni 17, paragrafi 2 përcakton se; për lejet e ndërtimi për punët ndërtimore që matën me metër katrorë (m²) për kategorinë II, ku tarifa për metër katrorë është 1.71€.

Gjatë auditimit të mostrës/lëndës e cila ka të bëjë me të hyrat nga lejet e ndërtimit, kemi vërejtur se komuna në një rast nuk kishte aplikuar si duhet këtë taksë. Komuna kishte ngarkuar aplikuesin në shumën 43,502€, derisa duhej të ngarkonte të njëjtin për shumën prej 27,449€.

Dobësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm kanë rezultuar me gabim në aplikimin e drejtë të tarifës administrative siç e parasheh rregullorja.

Ndikimi Mungesa e kontrolleve adekuate në aplikimin e tarifave të përcaktuara nga komuna, ndikojnë në dëmtimin e bizneseve dhe qytetarëve të cilët marrin shërbime nga komuna.

Rekomandimi A1 Kryetari duhet të sigurojë se kontrollet brenda drejtorive janë efektive në mënyrë që tarifat e përcaktuara të aplikohen drejtë dhe saktë në mënyrë që mos të dëmtohen pranuesit e këtyre shërbimeve.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A2 - Mangësi në pagesa për projektin kapital

Gjetja Bazuar në paragrafin 2 të nenit 24 të kontratës "Zgjerimi i rrugës Martirët e Kombit/Hyrja Perëndimore e Qytetit" mes Komunës së Gjakovës dhe OE ku specifikohet se; "Autoriteti kontraktues duhet të paguaj kontraktuesit shumën e certifikuar nga menaxheri i projektit brenda 30 ditëve nga data e çdo certifikate".

Gjatë testimit kemi vërejtur se në tri (3) mostra/pagesa të cilat lidhen me projektin "Zgjerimi i rrugës Martirët e Kombit/Hyrja Perëndimore e Qytetit", ishte paguar shuma prej 6,077€ më shumë sesa ishin realizuar punët për këtë projekt, edhe pse ende nuk janë kryer të gjitha situacionet për këtë projekt.

Kjo ka ndodhur për shkak të mungesës së kontrolleve të brendshme dhe mbikëqyrjes së dobët nga menaxherët e kontratave gjatë realizimit të projektit kapitale.

Ndikimi Aprovimi për pagesë i punëve të pa realizuara, ka ndikuar në dëmtimin e buxhetit dhe mos realizimin e kontratave, siç është planifikuar.

Rekomandimi A2 Kryetari duhet të shtojë masat e kontrollit në menaxhimin e kontratave dhe të sigurojë se menaxherët e kontratave dhe mbikëqyrësit e tyre të mos aprovjnë situacione të punëve të pa përfunduara në të kundërtën të rishikojnë pagesat e çdo situacioni me qëllim të barazimit para ekzekutimit

të pagesës së fundit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A3 - Vonesa në përfundimin e punëve të kontraktuara

Gjetja

Rregulla nr. 01/2022 për prokurim publik taksativisht në neni 70.23 pika b parashihet se menaxheri i kontratës duhet të sigurojë se operatori ekonomik kryen kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuar në kontratë. Në kontratat publike të nënshkruara mes komunës dhe kontraktuesëve, përcaktohen kushtet e veçanta kontraktuale si dhe afati kohor për realizimin e projektit. Menaxherët e kontratave duhet të monitorojnë dhe të sigurojnë se kontratat po realizohen si duhet dhe në afatin e përcaktuar.

Në dy (2) raste, kemi evidentuar vonesa në realizimin e projekteve, si në vijim:

- Kontrata "Ndërtimi i terreneve të tenisit" në vlerë 241,552€, e nënshkruar më datë 01.09.2023, nuk është kryer sipas planit dinamik prej 90 ditë që rezulton në vonesë rreth 2 muaj.
- Kontrata "Zgjerimi i rrugës Martirët e Kombit-Hyrja Perëndimore e Qytetit" në vlerë 1,004,545€, e nënshkruar më datë 03.08.2023, nuk është kryer sipas planit dinamik prej 120 ditë që rezulton në vonesë rreth 3 muaj.

Deri sa ishim nën auditim (prill 2024), këto dy projekte ende nuk ishin finalizuar.

Shkak i vonesave ishte dinamika jo adekuate e operatorëve për të përmbyllur projektin.

Ndikimi

Vonesat në kryerjen e projekteve mund të kenë implikime buxhetore për buxhetin e vitit pasues. Kjo po ashtu, ndikon drejtpërsëdrejti në mos ofrimin e infrastrukturës dhe shërbimeve me kohë për qytetarët.

Rekomandimi A3

Kryetari duhet të sigurojë vendosjen e kontrolleve në këtë fushë me një mbikëqyrje rigoroze në menaxhimin e kontratave. Realizimi i kontratave të bëhet në përputhje me planin dinamik/afatin për kryerjen e punëve/furnizimeve dhe për vonesat e pa arsyetuara, të aplikohen masat/ndëshkimet e parapara në kontratë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B2 - Dobësi në procesin e veprimtarive inspektuese të pronave

Gjetja

Sipas Ligji nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, nenit 15.2 përcakton se; veprimtaritë inspektuese kryhen çdo vit për të paktën njëzetë përqind (20%) të të gjitha objekteve brenda territorit të Komunës.

Komuna për vitin 2023 nuk ka arrit të kryej inspektimin e 20% të pronave të regjistruara, ku prej 38,209 të pronave, gjatë vitit 2023 ka inspektuar vetëm 4874 prej tyre, apo 13% të tyre.

Kjo ka ndodhur si rezultat i menaxhimit jo efikas të veprimtarive inspektuese dhe numrit të pamjaftueshëm të stafit.

- Ndikimi** Verifikimi jo i plotë i pronave për qëllime të tatimit në pronë, mund të rezultojë me informata jo të plota të pronës së tatueshme si dhe të ndikoj në vlerësim jo të saktë të të hyrave për tatimin në pronë dhe inkasimin e tyre.
- Rekomandimi B2** Kryetari të sigurojë përmirësimin e procesit të organizmit të veprimtarive inspektuese sipas kriterëve ligjore të përcaktuara në mënyrë që ndryshimet eventuale nga inspektimet të jenë regjistruar, ashtu që shënimet rreth tatimit në pronë të janë të plota.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B3 - Dobësi në përgatitjen e specifikacionit teknik në dosjet e tenderëve

- Gjetja** Ligji i prokurimit publik 04/L-042, neni 28, paragrafi 2 përcakton se; “Autoriteti kontraktues do t’i përpilojë specifikimet teknike në atë mënyrë që ato të jenë në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomik dhe tenderuesit. Autoriteti kontraktues është veçanërisht i ndaluar që të hartojë specifikime teknike që favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomik”.

Në dy raste të testimit të procedurave të prokurimit (për projektet: Rehabilitimi i rrugëve me asfalt dhe Zgjerimi i rrugës martirët e kombit-hyrja perendimore) kemi vërejtur se autoriteti kontraktues si në njoftimin për kontratë, ashtu edhe në dosjen e tenderit, të cilat lidhen me projekte infrastrukturore, kishte kërkuar nga ofertuesit të kenë një auditor udhëheqës (lead auditor) të licencuar nga autoritetet kompetente.

Kjo kishte ndodhur për faktin se njësia kërkuese kishte vendosur një kërkesë të tillë gjatë përpilimit të kërkesës për projektet në fjalë dhe zyra e prokurimit nuk kishte argument për ta larguar nga dosja e tenderit sepse nuk ishte kompetente.

- Ndikimi** Përgatitja e specifikimeve teknike duke iu referuar një elementi i cili nuk është substancial për projektin e synuar, dëmton konkurrencën dhe mund të ndikoj në favorizimin e operatorëve ekonomik të caktuar.
- Rekomandimi B3** Kryetari duhet të sigurojë se funksionon kontrolli i duhur përmes zyrës së prokurimit, ashtu që, të rishikoj se njësia kërkuese bëjnë hartimin e specifikimeve teknike sipas kërkesave ligjore dhe nevojave të komunës duke përcaktuar standardin e cilësisë së punës apo furnizimit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B4 - Vonesa në pagesën e faturave

Gjetja	Ligji nr. 03 /L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, neni 39.1 përcakton që secila faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagesë të mallrave dhe shërbimeve të paguhet brenda 30 ditëve kalendarike pas marrjes së faturës. Ndërsa, sipas nenit 40, fatura mund të ekzekutohet direkt nga Thesari pas marrjes së urdhërit të prerë nga gjykata/përmbaruesi. Nga testimi i mostrës për projektin "Mirëmbajtjen e auto rrugëve dhe gjelbërimit", kemi vërejtur vonesa në pagesën e faturave e tejkalojnë afatin e paraparë me ligjin aktual. Në pesë (5) raste faturat në vlerë totale prej 163,292€, pagesat nuk ishin bërë brenda afatit ligjor prej 30 ditësh. Vonesat janë nga 14 deri 191 ditë kalendarike. Për shkak të vonesave në pagesën e faturave, operatorët ekonomikë kanë përdorur procedura përmbarimore/gjyqësore për inkasimin e mjeteve. Megjithatë, nga analiza e raportit të shpenzimeve kemi vërejtur se komuna ka paguar borxhin kryesor 160,832€ dhe shpenzimet e interesit 5,588€ si rezultat i mosprocedimit të pagesave brenda afatit të përcaktuar ligjor. Shkak i mos pagesës me kohë të detyrimeve është mungesa e mjeteve buxhetore për pagesën me kohë e faturave nga drejtoritë përkatëse.
Ndikimi	Hyrja në obligime pa siguruar fondet e nevojshme, ndikon në rritjen e obligimeve të papaguara apo implikimeve buxhetore për vitin aktual, si dhe kosto financiare si rezultat i ngarkesave shtese në emër të kamatave dhe shërbimeve të përmbarimit.
Rekomandimi B4	Kryetari duhet të siguroj se hyrja në obligime bëhet vetëm pasi mjetet buxhetore të jenë zotuar paraprakisht, si dhe obligimet financiare ndaj kontraktuesve të paguhet brenda 30 ditëve nga data e pranimi të faturave në mënyrë që të shmangen pagesat shtesë të interesit nga vendimet gjyqësore/përmbarimore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**Çështja B5 - Mangësi në procedimin e pagesave**

Gjetja	Rregulla financiare nr.01/2013, neni 22 përcakton që; fillimisht duhet të bëhet kërkesa për blerje, më pas zotimi i mjeteve, të procedohet urdhër-blerja, pastaj të pranohet malli apo shërbimi, dhe pas pranimi të faturës të ekzekutohet pagesa. Gjatë testimit të kategorisë mallra dhe shërbime në dy raste, faturat në vlerë 33,895€, zotimi i mjeteve ishte bërë pas pranimi të mallit apo shërbimit/punëve dhe pranimi të faturës. Kjo ka ndodhur për faktin që nuk janë zbatuar rregullat për shpenzimin e parasë publike nga ana e zyrtarëve përgjegjës, si dhe nga mos planifikim i duhur i rrjedhës së parasë.
Ndikimi	Hyrja në obligime pa siguruar fondet e nevojshme paraprakisht, ndikon në

mos pagesën në kohë të obligimeve, të cilat e rëndojnë buxhetin e vitit pasues.

Rekomandimi B5 Kryetari të sigurojë se respektohen hapat e përcaktuar me rregullat në fuqi sa i përket realizimit të pagesave, në mënyrë që gjatë procedimit të pagesave, të bëhet fillimisht zotimi i mjeteve, pastaj të nxirret urdhër blerje dhe në fund të pranohet malli/shërbimi dhe të kryhet pagesa.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B6 - Dobësi në menaxhimin e projekteve përmes platformës elektronike të e-prokurimit

Gjetja Rregullorja nr. 001/2022, për prokurimin publik, neni 70, pika 2, Vlerësimi i performancës së kontraktuesve do të bëhet: i) në sistem të prokurimit elektronik nëpërmjet modulit për vlerësim të performancës së kontraktuesve; ii) nga menaxherët e kontratës dhe mbikqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, dhe iii) në pajtim me manualin për përdorim të modulit për vlerësim të performancës së kontraktuesve.

Nga testimi e bëra, ka rezultuar se në pesë procedura të prokurimit, menaxhimi i kontratave dhe vlerësimi i performancës së kontraktuesve nuk është mbajtur dhe arkivuar përmes sistemit elektronik të prokurimit publik (e-prokurimi).

Mos përdorimi i modulit për menaxhim të kontratës në e-prokurim ka ndodhur për mungesë të informatave/njohurive të duhura nga menaxherët e kontratave rreth aplikimit të modulit për menaxhimin e kontratës në e-prokurim.

Ndikimi Mos mbajtja dhe arkivimi i kontratave përmes sistemit të prokurimit publik, mund të ndikoj në një menaxhim jo të mirëfillt të kontratave. Mos raportimi për progresin e fizik të projekteve kapitale, dhe mos përditësimi i informatave rreth implementimit të kontratave në modulin elektronik pamundëson analizimin, përcjelljen dhe vlerësimin e performancës së realizimit të kontratës në kohë.

Rekomandimi B6 Kryetari duhet të sigurojë ndjekjen e trajnimeve për menaxherët e projekteve, për tu siguruar që menaxhimi i kontratave do të mbahet dhe arkivohet nga sistemi elektronik i prokurimit publik.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.3.1 Të arkëtueshmet

Komuna në PFV e vitit 2023 ka shpalosur llogari të arkëtueshme në vlerë prej 12,832,356€. Kjo vlerë përbehet tatimi në pronë 11,490,548€, qirat e dyqaneve 49,933€, qirat e tokave 267,727€, qirat e tregjeve 10€, qirat e parkingjet 8,522€ dhe taksa në firm 1,015,614€.

Çështja B7 - Rritje e llogarive të arkëtueshme

Gjetja

Ligji nr. 08/L-176 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjeve që Përmbajnë Procedura të Veçanta Administrative dhe Harmonizimin e tyre me Ligjin nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ka hyrë në fuqi më dt. 21.07.2023 dhe ka për qëllim harmonizimin e procedurave të veçanta administrative me procedurën e përgjithshme administrative, i cili ka plotësuar dhe ndryshuar disa ligje dhe një ndër to edhe Ligjin nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme. Ligj i lartë shënuar përmes nenit 112 ka ndryshuar procedurën e ekzekutimit të vendimit mbi detyrimet tatimore të papaguara, ashtu që për ekzekutimin e këtyre vendimeve (sipas nenit 30 të Ligjit bazik) nuk do të përdoret procedura e përmbartimit privat, por vetë komuna do t'i ekzekutojë duke i përdorur të njëjtat mjete që mund t'i përdor ATK për mbledhjen e detyrimeve tatimore të papaguara. Megjithatë, procedura përmbartimore mund të përdoret ndaj faturës së tatimit në pronë. Që nga hyrja në fuqi e këtij ligji nga komuna nuk duhet të iniciohet procedura e përmbartimit ndaj Vendimeve të nxjerra sipas nenit 30 të Ligjit bazik. Po ashtu edhe neni 16 i Rregullorës për Taksa Tarifa, Ngarkesa dhe Shërbimet Komunale, përcakton mbledhjen e detyrimeve tatimore të papaguara duke përdorur masat e mbledhjes së detyrueshme.

Llogaritë e arkëtueshme kanë rritje, krahasuar me vitin 2022. Në fund të vitit 2023 të arkëtueshmet ishin rritur për 1,325,662€, kjo vërehet tek ndërmarrjet shoqërore (tatimi në pronë dhe taksa në firmë), ku borxhi ka vlerën prej 4,198,250€. Rritja më e madhe e të arkëtueshmeve është në tatimin në pronë, krahasuar me vitin paraprak këtë vit obligimet ndaj tatimit në pronë janë rritur në vlerë 949,465€ apo në masën prej 9%.

Komuna kishte bërë përpjekje për inkasimin e mjeteve të pa arkëtuara nga tatimi në pronë, qiratë nga toka, dyqanet, tregjet apo taksat në firmë, përmes letërkujtesave si dhe vërejtjeve përfundimtare ndaj debitorëve, mirëpo këto masa nuk ishin mjaft efektive dhe trendi i rritjes së obligimeve ndaj komunës është negativ, për faktin e mosdërgimit të borxhlinjëve tek përmbartuesit.

Kjo ka ndodhur për shkak të kontrolleve dhe veprimeve të pamjaftueshme në arkëtimin e të hyrave.

Ndikimi

Mos arkëtimi në kohë i të hyrave të ngarkuara ndikon në nivelin e fondeve të mbledhura për buxhetin e komunës dhe reflekton negativisht në financimin dhe realizimin e projekteve komunale.

Rekomandimi B7

Kryetari duhet të analizoj efektivitetin e mekanizmave në dispozicion për mbledhjen e të arkëtueshmeve, duke përfshirë edhe veprimet ligjore shtesë përmes përmbartuesve, për të siguruar arkëtimin e plotë të tyre.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁵	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet
Burimet e fondeve	31,558,422	40,671,860	37,887,249	26,883,540	27,459,229
Grante Qeveritare - Buxheti	27,354,635	30,520,137	29,288,858	22,346,229	23,695,818
Financimi përmes huamarrjes	0	0	0	264,489	96,003
Të bartura nga viti i kaluar	0	3,418,527	2,846,991	1,677,526	621,817
Të hyrat vetanake	4,203,787	5,703,787	5,163,647	2,557,216	3,004,022
Donacionet vendore	0	46,772	0	23,807	30,946
Donacionet e jashtme	0	982,637	587,753	14,272	10,624

Buxheti final ishte më i lartë se buxheti fillestar për 9,113,438€. Kjo rritje është rezultat i pranimit të buxhetit nga të hyrave të bartura nga viti paraprak, niveli qendror, donacionet, huamarrja. Në vitin 2023 komuna ka shpenzuar 93% të buxhetit final, me një rritje prej 3% në krahasim me vitin 2022. Shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.


Shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	31,558,422	40,671,860	37,887,249	26,883,540	27,459,229
Pagat dhe mëditjet	15,120,092	18,297,786	18,295,920	14,345,541	15,812,416
Mallrat dhe shërbimet	3,750,000	4,218,744	4,136,946	3,858,972	3,258,299
Komunalitë	628,700	694,245	687,330	565,968	561,203
Subvencionet dhe transferet	620,500	760,321	695,219	614,000	591,454
Investimet Kapitale	11,439,130	16,700,762	14,071,834	7,499,060	7,235,857

- Buxheti final për paga dhe mëditje në raport me buxhetin fillestar në total ishte rritur për shumën 3,177,091€. Kjo rritje ishte sipas rishikimit të buxhetit për shumën 2,950,086€, ishte ndikuar prej vendimit të qeverise për shtesat në paga pakoja fiskale në shumë 215,415€, garantëve të përcaktuara të donatoreve në shumën 12,193€,
- Buxheti final për mallra dhe shërbime dhe komunalitë ishte rritur për shumën 534,289€, kjo rritje ishte ndikuar nga të hyrat e vitit aktual dhe të bartura nga viti i kaluar për shumën 516,273€ dhe granteve të përcaktuara të donatoreve në shumën 18,016€.
- Buxheti final për subvencione dhe transfere në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 139,821€, si rezultat i të hyrave të vitit aktual dhe atyre të bartura nga viti i kaluar 136,862€ dhe granteve të përcaktuara të donatorëve 2,959€.
- Buxheti final për investime kapitale në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 5,261,632€, ndryshimi në rritje ishte ndikuar nga të hyrat e vitit aktual si dhe ato të bartura në shumë prej 4,265,391€ dhe granteve të përcaktuara të donatorëve për 996,241€.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2023



Të hyrat e realizuara nga Komuna e Gjakovës në 2023 ishin në vlerë 6,673,351€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga qiraja, participimet etj. Përveç këtyre të hyrave komuna ka pranuar edhe të hyra indirekte të cilat grumbullohen nga niveli qendror në vlerë prej 840,912€ (gjobat në trafik 741,712€ dhe të hyrat nga gjykata në vlerë prej 50,062€) dhe të hyrat nga donatorët në shumën prej 969,564€.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti filleshtar	Buxheti final	2023 Pranimet	2022 Pranimet	2021 Pranimet
Totali i të hyrave	4,203,787	4,203,787	5,797,084	4,697,952	4,115,649
Të hyrat tatimore	2,703,682	2,703,682	2,742,878	2,296,134	2,313,597
Të hyrat jo tatimore	1,500,104	1,500,104	3,054,205	2,377,763	1,801,140
Të hyrat tjera	0	0		24,055	912

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2022 ka rezultuar me 15 rekomandime. Komuna kishte përgatitur Planin e Veprimit ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2023, tetë (8) rekomandime janë zbatuar dhe shtatë (7) rekomandime nuk janë adresuar ende, siç është paraqitur në Grafikon 2, më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën e rekomandimeve nr.4.

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2022	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për opinion	Kryetari duhet të sigurojë që të identifikohen rastet e kërkesave për pagesa përmes vendimeve gjyqësore, më tutje në bashkëpunim me Thesarin të kërkohej që paraprakisht të njoftohet Komuna, dhe që pagesa të bëhet nga kategoria ekomomike adekuatë.	Nuk janë ndërmarrë veprimet e nevojshme.	Nuk ka filluar zbatimin
2.	Baza për konkluzion	Kryetari të sigurojë se respektohen hapat e përcaktuar me rregullat në fuqi sa i përket realizimit të pagesave, në mënyrë që gjatë procedimit të pagesave, të bëhet fillimisht zotimi i mjeteve, pastaj të nxirret urdhër blerje dhe në fund të pranohet malli/shërbimi dhe të kryhet pagesa.	Nuk janë ndërmarrë veprimet e nevojshme.	Nuk ka filluar zbatimin
3.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë se vlerësimi i tenderëve të realizohet brenda afatit 30 ditor, dhe vetëm në raste të jashtëzakonshme dhe të justifikuara, në veçanti për kontratat e një natyre komplekse, kjo periudhë të zgjatet për një afat shtesë.	Ne nuk kemi hasur ne raste të tilla.	I zbatuar

4.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë ndjekjen e trajnimeve për menaxherët e projekteve, për tu siguruar që menaxhimi i kontratave do të mbahet dhe arkivohet nga sistemi elektronik i prokurimit publik.	Nuk janë ndërmarrë veprimet e nevojshme.	Nuk ka filluar zbatimi
5.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë se funksionon kontrolli i duhur përmes zyrës së prokurimit, ashtu që, të rishikoj se njësitë kërkuese bëjnë hartimin e specifikimeve teknike sipas kërkesave ligjore dhe nevojave të komunës duke përcaktuar standardin e cilësisë së punës apo furnizimit.	Nuk janë ndërmarrë veprimet e nevojshme.	Nuk ka filluar zbatimi
6.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të siguroj që të krijohen kushtet për funksionalizimin e web-aplikacionit, dhe që sa më parë të jetë në shërbim të qytetarëve.	Rekomandimi është adresuar,	I zbatuar
7.	Të hyrat	Kryetari duhet sigurojë një koordinim me të mirë ndërmjet zyrtarëve përgjegjës, që shqyrtimi i ankesave të tatimpaguesve bëhet brenda afateve ligjore.	Jane marre masat e nevojshme per adresimin e rekomandimit	I zbatuar
8.	Të hyrat	Kryetari të sigurojë përmirësimin e procesit të organizmit të veprimtarive inspektuese sipas kriterëve ligjore të përcaktuara në mënyrë që ndryshimet eventuale nga inspektimet të jenë regjistruar, ashtu që shënimet rreth tatimit në pronë të janë të plota.	Nuk janë ndërmarrë veprimet e nevojshme	Nuk ka filluar zbatimi
9.	Mallrat dhe shërbimet pa Komunalitë	Kryetari duhet të sigurojë planifikimin e drejtë të buxhetit duke forcuar disiplinën financiare që procesi i realizimit të pagesave të bëhet brenda planifikimeve buxhetore dhe afateve kohore të përcaktuara.	Nuk janë ndërmarrë veprimet e nevojshme.	I zbatuar
10.	Pasuritë	Kryetari duhet të sigurojë se procesi i menaxhimit të pasurive, të kryhet në pajtim me Rregulloren për menaxhimin e pasurive jo financiare.	Nuk janë ndërmarrë veprimet e nevojshme.	I zbatuar
11.	Pasuritë	Kryetari, duhet të siguroj që përdorimi i automjeteve dhe mbajtja e evidencave të tyre bëhet sipas kërkesave ligjore, si dhe të inicioj hartimin e një rregulloreje të brendshme për mënyrën e përdorimit të automjeteve zyrtare.	Rekomandimi është zbatuar.	I zbatuar
12.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari duhet të analizoj efektivitetin e mekanizmave në dispozicion për mbledhjen e të arkëtueshmeve, duke përfshirë edhe veprimet ligjore shtesë përmes përmbaruesve, për të siguruar arkëtimin e plotë të tyre.	Nuk janë ndërmarrë veprime të nevojshme.	Nuk ka filluar zbatimi

13.	Obligimet e papaguara	Kryetari duhet të sigurojë planifikim të buxhetit adekuat si dhe që, iniciimi i procedurave të shpenzimeve të realizohet vetëm kur mjetet janë në dispozicion me qëllim të eliminimit të detyrimeve ndaj OE-ve. Gjithashtu, Kryetari duhet sigurojë që të kryhen të gjitha detyrimet e viteve paraprake.	Nuk janë ndërmarrë veprime të nevojshme.	Nuk ka filluar zbatimi
14.	Detyrimet Kontigjente	Kryetari duhet të sigurojë një sistem të mirëfilltë të kontrollit në mënyrë që të krijohet dhe mirëmbahet regjistri i përgjithshëm i detyrimeve kontingjente në mënyrë që raportimi i tyre të jetë i saktë.	Jane marre veprimet e nevojshme, dhe jane shpalosur detyrimet kontigjente ne PVF.	I zbatuar
15.	Auditimi i Brendshëm	Kryetari duhet të rishikoj performancën e NJAB dhe sipas nevojës dhe mundësisë financiare dhe buxhetore të ndërmerr veprime për shtimin e kapaciteteve njerëzore brenda NJAB.	Jane marre veprimet e nevojshme per te zgjidhur ket rekomandim	I zbatuar

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Agron Fetiu, Ndihmës Auditor i Përgjithshëm



Ramadan Gashi, Drejtor i Auditimit



Fejzullah Fejza, Udhëheqës i ekipit



Astrit Bllaca, Anëtar i ekipit



Arbresha Breznica Rama, Anëtare e ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi



LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2023 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese:

Konfirmoj se përmes emailit, kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Gjakovës për vitin 2023 (në tekstin e mëtejshë "Raporti")

- Përkundër faktit dhe rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditimit, ne si Komunë i kemi ndjekur të gjitha hapat që mos të vijmë deri te kualifikimi i raportit.
- Sa i përket tërheqjes së njëanshme nga Departamenti i Thesarit në kuadër të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, nuk janë marrë parasysht emailët nga Komuna, korrigjimet e keq-klasifikimeve dhe vendimi nga Asambleja Komunale.
- Të gjitha këto dëshmi i kemi prezantuar tek Zyra Kombëtare e Auditimit.
- Brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Ardian Gjini

Kryetar i Komunës

Data: 24.06.2024



Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁶ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁷, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinion i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionin e auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjera", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁶ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁷ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.